



REKTORATI

Nr. 164/Prot

Tiranë, më 16.02.2023

VENDIM

“Mbi konfirmimin e regjistrimit nga studentët në Universitetin “Metropolitan Tirana” në fillim viti akademik ”

Në zbatim të Ligjit nr.80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutit e Rregullores së Brendshme të Universitetit “Metropolitan Tirana”, me qëllim mirëmenaxhimin e proceseve didaktike të Universitetit „Metropolitan Tirana“, Rektorati:

Vendosi:

1. Në çdo fillim viti akademik, studentët duhet të plotësojnë e dorëzojnë në sekretarinë mësimore formularin përkatës të lëshuar nga sekretaria mësimore ku konfirmojnë statusin e tyre student dhe regjistrimin pranë Universitetit „Metropolitan Tirana“.
2. Për vitin akademik 2022-2023, ky proces të realizohet në fillim të semestrit II.
3. Studentët që nuk plotësojnë këtë procedurë, do të konsiderohen studentë inaktivë.
4. Ky vendim të përcillet tek të gjithë studentët dhe strukturat UMT. Të publikohet në të gjitha kanalet e komunikimit të institucionit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi sekretaria mësimore.

Rektori

Prof. Dr. Nikolla Civici

